

BULETIN JAVOR

11-15 SHTATOR 2023



Shprehja

"Siguria Kibernetike është më shumë se thjesht një çështje IT"

e javës

Përmbajtja:


- Zëvendës Kryeministrja Znj. Belinda Balluku viziton Qendrën Operacionale të Sigurisë Kibernetike
- Turneu Virtual Kibernetik 14- 15 Shtator 2023



Zëvendës Kryeministrja Znj. Belinda Balluku viziton Qendrën Operacionale të Sigurisë Kibernetike

Zv.Kryeministrja Znj. Belinda Balluku vizitoi Qendrën Operacionale të Sigurisë Kibernetike, pranë AKCESK, ku monitorohen në kohë reale të gjitha kërcënimet kibernetike ndaj vendit tonë.

Shqipëria është shumë më e sigurtë se një vit më parë, falë përkushtimit dhe punës së të gjithë aktorëve qeveritarë dhe privatë, si dhe mbështetjes së vazhdueshme të partnerëve tanë strategjikë.



Turneu Virtual Kibernetik

Në datat 14 - 15 Shtator 2023, SANS në bashkëpunim me AKCESK organizuan turneun virtual kibernetik, në formatin e një aktiviteti "Capture the Flag", krijuar ekskluzivisht për komunitetin e sigurisë kibernetike të Evropës Qendrore dhe Lindore.

SANS Boot-up CTF ishte një konkurs argëtues, ku pjesmarrësit praktikuan aftësi teknike të sigurisë kibernetike. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme ata zbuluan pikat e tyre të forta dhe sfiduan limitet!

BULETINI JAVOR

11-15 SHTATOR 2023




Shprehja

"Siguria Kibernetike është më shumë se thjesht një çështje IT"

e javës

Përmbajtja:

- Adobe Acrobat dhe Adobe Reader *patch-ojnë* vulnerabilitetin e shfrytëzuar në mënyrë aktive
- Microsoft paralajmëron për një fushatë të re phishing
- Miliona të infektuar nga Spyware të fshehura në aplikacionet e rreme të Telegramit në Google Play
- Microsoft - patching alert



Miliona të infektuar nga Spyware të fshehura në aplikacionet e rreme të Telegramit në Google Play


Spyware të maskuar si versione të modifikuara të Telegram janë hasur në Google Play Store.

Aplikacionet janë shkarkuar miliona herë përpara se të hiqeshin nga Google dhe shërbenin për të mbledhur miliona informacione të ndjeshme nga pajisjet Android.

Aplikacione të ngjashme me Telegram dhe WhatsApp janë zbuluar më parë, në Mars 2023, të cilat ishin pajisur me funksionalitetin e përgjimit dhe modifikimit të mesazheve, si dhe për të ridrejtuar transferimet e kriptomonedhave në portofolët e hackerave.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Microsoft publikon patche për dy vulnerabilitete të reja të shfrytëzuara në mënyrë aktive

Microsoft ka publikuar përditësime për 59 vulnerabilitete, duke përfshirë dy vulnerabilitete të tipit zero-day, të cilat janë shfrytëzuar në mënyrë aktive nga aktorë keqdashës kibernetikë.

Nga 59 vulnerabilitetet, pesë vlerësohen si kritike.

AKCESK rekomandon përdoruesit e Microsoft, të realizojnë sa më parë përditësimet.

[Link: Lexo më shumë](#)




Adobe Acrobat dhe Adobe Reader përditësojnë vulnerabilitetin e shfrytëzuar në mënyrë aktive

Përditësimi i Adobe Patch Tuesday për Shtator 2023 vjen me një *patch* për një vulnerabilitet të shfrytëzuar në mënyrë aktive në Acrobat dhe Adobe Reader, i cili mund të lejojë një sulmues të ekzekutojë kodin keqdashës në sistemet vulnerabël.

Vulnerabiliteti, i identifikuar si CVE-2023-26369, vlerësohet me severitet CVSS 7.8 dhe ndikon në versionet Windows dhe macOS të Acrobat DC, Acrobat Reader DC, Acrobat 2020 dhe Acrobat Reader 2020.

[Link: Lexo më shumë](#)



Microsoft paralajmëron për një fushatë të re phishing

Microsoft po paralajmëron për një fushatë të re *phishing*, i cili përfshin përdorimin e mesazheve të Teams për të depërtuar në rrjetet e organizatave.

Ekipi i Inteligjencës së Kërcënimeve të gjigantit të teknologjisë po gjurmon grupin me emrin Storm-0324, i cili njihet gjithashtu me emrat TA543 dhe Sagrid.

[Link: Lexo më shumë](#)